



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË
ORGANIZUAR, TIRANË

MIRATOHET
DREJTUESI I PROKURORISË
ARBEN KRAJA



RREGULLORE
Nr. 248, datë 27.04.2022

PËR CAKTIMIN E RREGULLAVE PËR ORGANIZIMIN E PROÇEDURËS SË
KONKURIMIT DHE EMËRIMIT TË HETUESVE TË SEKTORIT TË HETIMIT
FINANCIAR NË PROKURORINË E POSAÇME

Në mbështetje të neneve 7 dhe 21 të Ligjit 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të ndryshuar, neneve 10/2, 17 dhe 18/4 të ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, të Urdhërit nr.227, datë 11.04.2022 të Drejtuesi të Prokurorisë së Posaçme “Mbi Komisionin dhe procedurën e përzgjedhjes së hetuesve të Sektorit të Hetimit Financiar në Prokurorinë e Posaçme”,

KOMISIONI I PËRZGJEDHJES SË HETUESVE TË SEKTORIT TË HETIMIT
FINANCIAR NË PROKURORINË E POSAÇME

Miraton këto rregulla:

Për organizimin e procedurës së konkurimit dhe emërimit të hetuesve në Sektorin e Hetimit
Financiar në Prokurorinë e Posaçme.

Neni 1

Objekti i rregullores

Objekti i kësaj rregullore është përcaktimi i rregullave për organizimin e procedurës së konkurimit dhe emërimit të hetuesve të Sektorit të Hetimit Financiar në Prokurorinë e Posaçme.

Neni 2

Procedura e emërimit

1. Emërimi i hetuesve të Sektorit të Hetimit Financiar në Prokurorinë e Posaçme bëhet nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, bazuar në rezultatet e konkurimit të nxjerra nga Komisioni i Përzgjedhjes së Hetuesve të Sektorit të Hetimit Financiar në Prokurorinë e Posaçme.
2. Emërimi i hetuesve të Sektorit të Hetimit Financiar në Prokurorinë e Posaçme bëhet nëpërmjet një procesi konkurimi të hapur dhe transparent.

Neni 3

Vëndet e lira

1. Shpallja e vendeve të lira bëhet me urdhër të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme dhe përmban:
 - a. numrin e vendeve të lira për hetues në Sektorin e Hetimit Financiar për të cilat do të bëhet konkurimi;
 - b. aftësitë dhe cilësitë që do të vlerësohen në konkurim, fazat në të cilat do të kalojë konkurimi;
 - c. listën e dokumentave që duhet të dorëzojnë aplikantët dhe afatin e dorëzimit të tyre;
 - d. nivelin e pagës mujore të vëndit vakant.
2. Shpallja e vendeve të lira bëhet në faqen zyrtare të internetit të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
3. Shpallja e vendeve vakante bëhet të paktën 15 ditë përpara datës së caktuar për konkurim.

Neni 4

Paraqitja e dokumentacionit

1. Kandidatët që shfaqin interes për të marrë pjesë në konkurim duhet që brenda afatit të përcaktuar nga Prokuroria e Posaçme, të dorëzojnë pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Posaçme dokumentacionin e kërkuar, i cili, duhet të përmbajë:
 - a. Kërkesën për t'u emëruar hetues në Sektorin e Hetimit Financiar në Prokurorinë e Posaçme;
 - b. Jetëshkrimin e detajuar të kandidatit;
 - c. Kopjen e diplomës dhe listës së notave, të arsimit të lartë dhe çdo dokument tjetër që tregon plotësimin e kriterit të arsimit, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë;
 - d. Librezën e punës ose çdo dokument tjetër që vërteton përvojën në punë të kandidatit si oficer i policisë gjyqësore në seksionet e policisë gjyqësore, si oficer i policisë gjyqësore në shërbimet e policisë gjyqësore ose si oficer i policisë gjyqësore në organe dhe institucione të tjera të cilëve ligji iu ngarkon kompetenca të policisë gjyqësore dhe iu njeh attribute të policisë gjyqësore;
 - e. Vlerësime të mëparshme të punës ose në mungesë të një vlerësimi pune letër rekomandim nga eprori në institucionin ku aplikanti është i punësuar apo ka qënë i punësuar;

- f. Dëshmi të gjuhëve të huaja dhe dëshmi të trajnimeve që ka kryer (nëqoftë se ka);
 - g. Dëshmi penaliteti që tregon se kandidati nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale dhe vërtetime nga gjykata dhe prokuroria që vërtetojnë se nuk është në ndjekje penale apo gjykim për kryerjen e ndonjë vepre penale;
 - h. Dokument që vërteton se ndaj kandidatit nuk ka në fuqi ndonjë masë disiplinore dhe se në momentin e konkurimit nuk ka filluar procedim disiplinor ndaj tij.
2. Kandidatët që shfaqin interes për të marrë pjesë në konkurim, në zbatim të nenit 6, paragrafi (2) të ligjit nr.95/2016, në momentin e aplikimit duhet të japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, duke nënshkruar dhe paraqitur deklaratën me shkrim sipas shtojcave B2 dhe B3 të këtij ligji.
3. Dokumentacioni i aplikimit dorëzohet në Sektorin e Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Posaçme, në origjinal ose në formën e njësuar me origjinalin. Kandidatët pajisen me vërtetim për dorëzimin e kërkesës dhe të listës së dokumentave.

Neni 5

Komisioni i përzgjedhjes

1. Vlerësimi i aftësive të kandidatëve do të kryhet nga Komisioni i përzgjedhjes, me tre anëtarë prokurorë në Prokurorinë e Posaçme, të caktuar nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.
2. Komisioni i përzgjedhjes ka për detyrë të kryejë vlerësimin e aftësive të kandidatëve për hetues në Sektorin e Hetimit Financiar, sipas procedurës së konkurimit të parashikuar në këtë rregullore dhe pas përfundimit të konkurimit të nxjerrë menjëherë rezultatet përfundimtare.
3. Anëtarët e Komisionit të përzgjedhjes duhet të deklarojnë paraprakisht nëse ndonjëri prej tyre është në kushtet e konfliktit të interesit me kandidatet që marrin pjesë në konkurim. Në rast se anëtari i Komisionit ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, zëvendësohet nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme me një prokuror tjetër.
4. Komisioni i përzgjedhjes ndihmohet në punën e tij nga administrata e Prokurorisë së Posaçme.

Neni 6

Procedura e konkurimit

1. Konkurimi zhvillohet në dy etapa:
 - a. Verifikimi paraprak, i cili, ka për qëllim të verifikojë nëse kandidatët plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta të përcaktuara në nenin 21 të ligjit nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” dhe të publikuara në shpalljen për konkurim.
 - b. Vlerësimi i kandidatëve.
2. Verifikimi paraprak bëhet mbi bazën e dokumentave (fotokopje të njësuara) të paraqitura nga kandidatet dhe kryhet nga Sektori i Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Posaçme, brenda 15 ditëve nga data e mbylljes së pranimit të dokumentave.

3. Pas përfundimit të vlerësimit paraprak, Sektori i Burimeve Njerezore, harton listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret e parashikuara nga neni 21 të ligjit nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”. Renditja në listë bëhet sipas rendit alfabetik dhe i dorëzohet Komisionit të përzgjedhjes.
4. Lista me kandidatët e kualifikuar shpallet në faqen zyrtare të internetit të Prokurorisë Posaçme.
5. Kandidatët, që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në shpalljen për konkurim, Sektori i Burimeve Njerezore në Prokurorinë e Posaçme i rendit në një listë të veçantë, në të cilën, tregohen dhe arsyet e mosplotësimit të këtyre kriterëve. Lista administrohet nga Sektori i Burimeve Njerezore dhe nuk bëhet publike. Kandidatët që nuk janë kualifikuar njoftohen individualisht nga Sektori i Burimeve Njerezore në Prokurorinë e Posaçme.
6. Brenda 5 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual, sipas pikes 5, të kësaj rregulloreje, kandidatët që nuk janë kualifikuar, kanë të drejtë të paraqesin ankesë me shkrim pranë Komisionit të përzgjedhjes. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.
7. Pas vlerësimit paraprak të kryer nga Sektori i Burimeve Njerezore, kandidatët e kualifikuar, i nënshtrohen vlerësimit nëpërmjet testimit profesional. Vlerësimi i kandidatëve nëpërmjet testimit profesional kalon në tre faza nëpërmjet një procesi pikëzimi dhe përfshin:
 - a. Faza e parë, vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës në punë e të trajnimeve të lidhura me fushën;
 - b. Faza e dytë, vlerësimi me shkrim;
 - c. Faza e tretë, intervista e strukturuar me gojë;
8. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100, të cilat ndahen përkatësisht:
 - a. Për fazën e parë vlerësimi sipas arsimit, përvojës së punës dhe jetëshkrimit, kandidatët mund të marrin deri në 15 pikë, duke ndjekur shkallët e pikëzimit për:
 - i. Përvojën në punë mbi 2 vjet si oficer i policisë gjyqësore,
 - ii. Përvojën në punë si oficer i policisë gjyqësore në hetimin e veprave penale në fushën e hetimit financiar,
 - iii. Përvojën në punë në funksione të tjera të mëparshme të lidhura me hetimin financiar,
 - iv. Arsimi përfshirë diplomë pasuniversitare,
 - v. Vlerësimi i mëparshëm i punës, gjuhë të huaja dhe kualifikime të tjera.

Komisioni pasi ka bërë vlerësimin e jetëshkrimit të kandidatëve njofton kandidatët për orën, vëndin dhe kohën se kur do të kryhet testimi me shkrim. Ky njoftim duhet të bëhet pesë ditë para kryerjes së tij. Njoftimi bëhet nëpërmjet shpalljes në faqen zyrtare të Prokurorisë së Posaçme.

- b. Për fazën e dytë, në të cilën kryhet testimi profesional nëpërmjet zhvillimit të testimit me shkrim, kandidatët mund të marrin deri në 50 pikë. Testimi me shkrim përmban një test teorik dhe një test praktik.

Programi për testimin me shkrim, i cili përmban njohuritë e përgjithshme dhe specifike nga fusha e të drejtës penale materiale, nga fusha e të drejtës penale procedurale, si dhe nga fusha e hetimit financiar, përgatitet nga Komisioni i

përzgjedhjes dhe iu vihet në dispozicion kandidatëve me paraqitjen e dokumentave sipas nenit 4 të kësaj rregullore.

Komisioni i vlerësimit 24 orë përpara zhvillimit të fazës së testimit me shkrim zgjedh brenda programit të testimit, pyetjet për testimin e fushës së njohurive, aftësive e të cilësive që nevojiten për ushtrimin e funksionit nga hetuesi i Sektorit të Hetimit Financiar.

Nëse kandidati grumbullon minimumi 40 pikë nga vlerësimi i jetëshkrimit dhe vlerësimi me shkrim, kualifikohet për intervistën e strukturuar me gojë.

- c. Për fazën e tretë, intervista e strukturuar me gojë, e cila, ka për qëllim vlerësimin e njohurive, aftësive dhe formimit të kandidateve, kandidatët mund të marrin deri në 35 pikë.

Intervista me gojë përqëndrohet në njohuritë e përgjithshme të kandidatëve, të cilat tregojnë formimin tërësor të tyre, njohuritë në fushën e zbatimit të kërkesave të Kodit të Proçedurës Penale, njohuritë mbi normat që parashikohen në Kodin Penal, në përvojën dhe në njohuritë e kandidatëve në fushën e hetimit financiar, në fushën e sekuestrimeve dhe të konfiskimeve.

Komisioni i përzgjedhjes, ditën e intervistës së strukturuar me gojë zgjedh një grup të njëjtë pyetjesh për të gjithë kandidatët. Gjithashtu Komisioni cakton dhe datën se kur do të zhvillohet intervista me gojë dhe njofton kandidatët e kualifikuar.

9. Komisioni i përzgjedhjes në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidateve harton listën e kandidatëve duke filluar nga kandidati me rezultatin më të lartë. Lista me renditjen e kandidatëve sipas pikëve i dërgohet Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme brenda 24 orëve nga përpilimi i saj. Rezultatet e konkurimi iu njoftohen kandidatëve.

10. Në listën e emrave nga e cila do të përzgjidhen hetuesit e Sektorit të Hetimit Financiar të Prokurorisë së Posaçme, futen kandidatët që në përfundim të konkurimit kanë grumbulluar pikët më të larta se kandidatët e tjerë dhe në të njëjtën kohë të kenë grumbulluar në minimum 70 pikë.

Neni 7

Verifikimi i pasurisë dhe pastërtisë së figurës

1. Kandidatët që kanë kaluar fazën e konkurimit dhe janë përzgjedhur në listën fituese, bazuar në nenin 6 të ligjit nr.95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, do të dorëzojnë deklaratat e kontrollit të pasurisë dhe deklaratën e vlerësimit të figurës sipas shtojcave A dhe C të këtij ligji.

2. Verifikimi i pasurisë dhe pastërtisë së figurës do të kryhet nga Komisioni i Posaçëm për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në Prokurorinë e Posaçme, i cili kryhen verifikimet e nevojshme sipas parashikimeve të neneve 6 dhe 12 të ligjit nr.95/2016.

3. Në përfundim të procesit Komisioni i Posaçëm për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në Prokurorinë e Posaçme i paraqet Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme raportin për verifikimin e pasurisë dhe të pastërtisë së figurës së kandidatëve.

Neni 8

Emërimi në detyrë

1. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në përfundim të procesit të verifikimit të pasurisë dhe të pastërtisë së figurës, emëron në detyrën e hetuesit në Sektorin e Hetimit Financiar në Prokurorinë e Posaçme, kandidatët fitues në procedurën e konkurimit që kanë kaluar me sukses procesin e verifikimit të pasurisë dhe pastërtisë së figurës.
2. Në rast se numri i kandidatëve të kualifikuar nga Komisioni i Posaçëm për verifikimin e pasurisë dhe pastërtisë së figurës është më i vogël se numri i vendeve vakante, procesi i përzgjedhjes vazhdon me kandidatët e tjerë në listë, të cilët në përfundim të konkurimit kanë grumbulluar jo më pak se 70 pikë. Nëse nuk ka kandidatë tjerë në listë me këtë nivel pikësh, atëherë për vendet e mbetura vakante zhvillohet një procedurë e re konkurimi.

Neni 9

Ankimi

Kandidatët konkuroes kanë të drejtën të bëjnë ankim me shkrim te Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme për rezultatin e pikëve dhe renditjen në listën fituese. Afati i ankimit është 5 ditë kalendarike nga:

- a) Data e njoftimit individual të rezultatit të vlerësimit të jetëshkrimit dhe vlerësimit me shkrim për kandidatët që kanë grumbulluar më pak se 40 pikë.
- b) Data e njoftimit individual të rezultatit të vlerësimit për kandidatët që kanë marrë pjesë në të tre fazat e vlerësimit të përcaktuara në nenin 6, pika 7 e kesaj rregullore.

Ankuesit marrin përgjigje brënda pesë ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit ankimor të përcaktuar në shkronjen b) të këtij neni. Në përfundim të këtij afati hartohet lista përfundimtare e fituesve.

Neni 10

Dokumentimi

Në çdo fazë të procedurës, veprimet dokumentohen me procesverbal, i cili, nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit të përzgjedhjes.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në momentin e miratimit nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe publikohet në faqen e internetit të Prokurorisë së Posaçme.